



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:019397  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05725426

**A.C.nr.7242/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A, (KEDS) sh.a, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.3, ndërtesa e Elektro Kosovës, kati II, nr.5, me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurit S(E)F. me vendbanim në fshatin P..., Komuna Podujevë, në çështjen kontestimore për kompenzim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.130/2020 datë 15.06.2021 dhe aktvendimit korigjues të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.130/2020 datë 01.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.05.2024, mori këtë:

## A K T V E N D I M

**I. HEDHET** ankesa e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A, (KEDS) sh.a, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.3, ndërtesa e ElektroKosovës, kati II, nr.5, me seli në Komuna Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.130/2020 datë 15.06.2021, e **PA LEJUAR**.

**II. REFUZOHET** ankesa e të paditurit S(E)F. me vendbanim në fshatin P..., Komuna Podujevë, ndërsa aktvendimi korigjues i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.130/2020 datë 01.07.2021, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.130/2020 datë 15.06.2021 dhe atë me aktvendim korigjues C.nr.130/2020 datë 01.07.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“...I. APROVOHET në tërësi SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) sh.a., Bulevardi “Bill Clinton”, nr.3, ndërtesa e ElektroKosovës, kati II, nr.5, me seli në Prishtinë dhe OBLIGOHET i padituri S.E.F., nga fshati P..., Komuna e Podujevës, që paditëses të i'a paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 149.64 €uro, me kamatën ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive. Shumën e aprovuari padituri detyrohet t'ia paguaj paditëses në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.*

*II. Refuzohet kërkesa e palës paditëse për shpenzimet e procedurës kontestimore prej 20.00 euro si e pa bazuar.*

*III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”*

*“Po ashtu me aktvendim korigjues C.nr.130/2020 datë 01.07.2021 ka bërë përmirësimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve C.nr.130/2020 datë 15.06.2021 sa i përket vlerës së kontesti – dëmit si në hyrje, dispozitiv dhe arsyetim të aktgjykimit dhe aty ku është shënuar “shuma prej 149,64 euro”, ndërsa në të dhëna të tjera mbesin të pandryshuara. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e Aktgjykimit C.nr.130/2020 datë 15.06.2021...”*

Kundër aktgjykimit C.nr.130/2020 datë 15.06.2021, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të: *shkeljeve esenciale të dispozitave ligjor dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike*, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë të bazuar ankesën e paditësit, ta ndryshojë aktgjykimin duke vendosur si në petitum të kërkesëpadsisë ose të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër aktvendimit korigjues C.nr.130/2020 datë 01.07.2021, brenda afatit ligjore ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të : *shkeljes së drejtës materiale, të shkeljes së të drejtës procedurale, të fakteve të gabuara dhe të shkeljes së drejtës ligjore*, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta hudh në tërësi si të pabazuar aktvendimin korigjues e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë C.nr.130/2020 datë 01.07.2021.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- **Ankesa e paditësit është e palejuar.**
- **Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A, (KEDS) sh.a, ka parashtruar padi me datë 10.02.2020 kundër të paditurit S(E)F., për kompensim të dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, pa dëgjimin e palëve ndërgjyqëse, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga përshkrimi i treguar në padi dhe me Aktgjykimin C.nr.130/2020 datë 15.06.2021, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se *"...Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i LPK – së, me të cilin përcaktohet se: "Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore të jep aktgjykim", lidhur me nenet 143 dhe 147 të LPK – së, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor, andaj shihet se i padituri nuk e ka paguar borxhin paditëses, mirëpo e ka paguar vetëm dënimin e dhënë në Divizionin Penal... Gjykata duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara ... "*

Në Gjykatën e shkallës së parë, pala paditëse ka parashtruar parashtresë për korrigjimin e aktgjykimit.

Paditësi me datë 13.07.2021, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ka paraqitur parashtresë më të cilën e tërheq ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit C.nr.130/2020 datë 15.06.2021, me të cilën është aprovuar padia e paditësit në tërësi si e bazuar.

Andaj bazuar në faktin se paditësi e ka tërheq ankesën, Gjykata e Apelit e ka hedhur ankesën si të palejueshme, duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 1 e lidhur me paragrafin 3 të të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *"ankesa është e palejueshme po që se e ka parashtruar personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga*

*e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”.*

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktvendimi korrigjues i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktvendimit të atakuar është mjaft i kjartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nuk qëndronë pasi që dispozitivi i Aktvendimit është i kuptueshëm, i kjartë dhe arsyetimi i Aktvendimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktvendimit.

Në këtë procedurë kontestimore nuk është kontestuese se pala paditëse ka parashtruar padi ndaj palës së paditur për kompensim dëmi, dhe në padi ndër të tjera ka kërkuar që pala e paditur të ja paguaj palës paditëse shumën prej 496.94€uro.

Po ashtu nuk është kontestuese se Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim C.nr.130/2020 datë 15.06.2021 pa shqyrtim kryesor, me të cilin aktgjykim ka vendosur që i padituri të ia paguaj dëmin paditëses në shumë prej 149.64 €, ndaj të cilit aktgjykim me të cilin është vendosur në mënyrë meritore pala e paditur nuk ka parashtruar ankesë.

Pala paditëse, duke u bazuar në kërkesëpadinë e parashtruar në Gjykatë, dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka parashtruar parashtresë në Gjykatë për korrigjimin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, me datë 01.07.2021, ka marrë aktvendim korrigjues, me të cilin aktvendim e bërë përmirësimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Podujevë, C.nr.130 datë 15.06.2021 sa i përket vlerës së kontestit – dëmit në vend të shumës 149.64 €, ka konstatuar se duhet të jetë shuma prej 496.64 €uro.

Në nenin 165 par. 1 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, në mënyrë decidive thuhet se: *“Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë...”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i kjartë, dhe rrjedhimisht i njëjti është në harmoni edhe me arsyetimin e aktvendimit.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore të të paditurit të parashtruara në ankesë, Gjykata e Apelit i mori parasysh dhe gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e lartpërmendura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 209 par.1 pika a) dhe b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.7242/2021 datë 22.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**